



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 06 Prill 2021

Nr: 13

**VENDIM**

**PËR**

**“PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR RAPORTIMIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE  
ZGJEDHORE, KONTROLLIN DHE VERIFIKIMIN E FINANCIMEVE DHE  
SHPENZIMEVE TË TYRE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE”**

*(ndryshuar me vendimin nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator)*

Në mbështetje të neneve 20, pika 1, shkronja “F”, 92/1, 92/2, 92/3, 92/6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

KOMISIONI RREGULLATOR

V E N D O S:

**Neni 1**

**Objekti**

Ky vendim ka si objekt:

- përcaktimin e rregullave të veçanta për plotësimin, depozitimin, kontrollin dhe verifikimin e raporteve financiare që dorëzojnë partitë politike kur konkurojnë më vete apo si pjesë e një koalicioni përfshirë kandidatët e tyre dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.
- miratimin e modeleve të raportimit për partitë politike, kandidatët e tyre dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit,
- miratimin e modelit të raportit të auditimit nga auditueset e caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për të kontrolluar raportet financiare për fushatën zgjedhore të subjekteve të përcaktuar në shkronjën “a” të këtij neni.
- afatet për publikimin e raporteve,
- përcaktimin e rolit dhe të përgjegjësisë të financierëve të subjekteve të përcaktuar në shkronjën “a” të këtij neni.

**Neni 2**

**Raportet e monitorimit**



1. Monitoruesit e zgjedhjeve, të caktuar nga KQZ për monitorimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së subjekteve zgjedhore me detyrimet sipas Kodit Zgjedhor dhe/ose akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, dorëzojnë në KQZ:
  - a) raportin e ndërmjetëm çdo 10 ditë nga fillimi i periudhës së monitorimit deri në ditën e zgjedhjeve,
  - b) raportin mbi shkeljen e vërejtur gjatë monitorimit të zgjedhjeve për Kuvend (të incidenteve) në të njëjtën ditë që bëhet vëzhgimi,
  - c) raportin përfundimtar të monitorimit, jo më vonë se 7 ditë pas ditës së zgjedhjeve.
2. Raportet e ndërmjetme, të incidenteve dhe raporti përfundimtar i monitorimit publikohen në faqen e internetit të KQZ-së brenda 2 (dy) ditëve pune nga depozitimi i tyre në KQZ. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve publikon gjithashtu çdo masë apo vendim që ka marrë në lidhje me këto raporte.

### Neni 3

#### Raporti Financiar për Fushatën Zgjedhore

*(Shtuar pikat 1/1 dhe 2/1 me vendimin nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator)*

1. Partitë politike kur konkurojnë më vete apo si pjesë e një koalicioni, kandidatët e tyre si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit të regjistruar si subjekte zgjedhore duhet të depozitojnë në KQZ, raportin financiar për fushatën zgjedhore brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve. Raporti depozitohet në KQZ në një kopje fizike dhe një kopje elektronike.
- 1/1. Raporti financiar për fushatën zgjedhore i subjektit zgjedhor përmban informacion të hollësishëm për bilancin e aseteve dhe detyrimeve për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, sipas shtojcës nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Formatet e raporteve financiare për fushatën zgjedhore plotësohen sipas modeleve që i bashkëlidhen këtij vendimi si më poshtë vijon:
  - a) shtojca nr. 1, për partitë politike;
  - b) shtojca nr. 2, për kandidatët e listave shumëmemërore;
  - c) shtojca nr. 3, për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.
- 2/1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u mundëson subjekteve zgjedhore dorëzimin e raporteve financiare të fushatës zgjedhore edhe nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar (PERF), e cila gjendet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al). Plotësimi dhe dorëzimi i raportit financiar të fushatës zgjedhore nëpërmjet Platformës Elektronike të Raportimit Financiar bëhet sipas procedurave të parashikuara në aktin përkatës të miratuar nga KQZ-ja.
3. Raporti financiar për fushatën zgjedhore publikohet në faqen e internetit të KQZ brenda 2 (dy) ditëve pune nga depozitimi i tij në KQZ.
4. Subjektet zgjedhore publikojnë raportin në faqen e tyre zyrtare të internetit brenda 3 (tre) ditëve nga dorëzimi i tij në KQZ-së.

### Neni 4

#### Kontrolli paraprak i raporteve financiare



1. Administrata e KQZ-së kryen kontrollin paraprak (prima facie) të raportit financiar për fushatën zgjedhore dhe njofton subjektet e percaktuara në nenin 1, gërma “a” të këtij vendimi, nëse evidenton mangësi, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga dorëzimi i tij.
2. Objekti i kontrollit paraprak të raportit financiar për fushatën zgjedhore është vetëm verifikimi i elementeve të formës juridike nëse janë sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.
3. Në rastet kur janë evidentuar mangësi sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni të këtij neni, subjektet e percaktuara në nenin 1, gërma “a” të këtij vendimi, jo më vonë se 72 (shtatëdhjetë e dy) orë nga marrja e njoftimit nga KQZ, duhet të ridepozitojë raportin e korrigjuar ose sipas rastit të depozitojë shpjegimet përkatëse për mangësitë e konstatuara.
4. Raporti financiar për fushatën zgjedhore i korrigjuar, ose sipas rastit, shpjegimet e subjekteve të percaktuara në nenin 1, gërma “a” të këtij vendimi, publikohen nga KQZ-ja në faqen zyrtare të internetit jo më vonë se 10 ditë pas ridepozitimit të tij.

## Neni 5

### Raporti i Auditimit

*(Shtuar pika 1/1 dhe ndryshuar shtojca nr. 4 e pikës 2, me vendimin nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator)*

1. Audituesi i përzgjedhur nga KQZ-ja për të kontrolluar fondet e marra dhe shpenzimet e kryera nga subjektet e percaktuara në nenin 1, gërma “a” të këtij vendimi gjatë fushatës zgjedhore, dorëzon raportin e auditimit në kopje fizike dhe në formë elektronike në KQZ sipas afateve të percaktuara në kontratë.
- 1/1. Audituesi ligjor i dorëzon projekt-raportin e auditimit subjektit zgjedhor, të cilit i jepet mundësia për t’u njohur paraprakisht me gjetjet nga auditimi i pasqyrave financiare dhe për t’ju përgjigjur me observacione ose materiale shtesë, audituesit ligjor për të pasur një raport auditimi përfundimtar sa më të plotë duke pasqyruar situatën reale financiare. Format i standardizuar i projekt-raportit të auditimit përmban gjetje dhe rekomandime përkatëse sipas shtojcës nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Raporti i auditimit hartohet sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Raporti i auditimit publikohet në faqen e internetit të KQZ-së jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së raportit ose, sipas rastit, nga data e mbylljes së verifikimeve përkatëse.

## Neni 6

### Verifikimi dhe kontrolli i raporteve financiare të subjekteve zgjedhore

*(Ndryshuar shtojca nr. 5 e pikës 2, shkronja “b”, me vendimin nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator)*

1. Administrata e KQZ-së ka të drejtë të verifikojë dhe kontrollojë respektimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe/ose akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij për fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga subjektet e percaktuara në nenin 1, gërma “a” të këtij vendimi gjatë fushatës zgjedhore. Afati i verifikimit të raportit financiar për fushatën zgjedhore është jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e dorëzimit të tij në KQZ. Ky afat mund të shtyhet me vendim të Komisionerit Shtetëror

të Zgjedhjeve jo më shumë se 15 ditë të tjera, në rastet e kryerjes së hetimeve të thelluara ose ku raporti përmban çështje komplekse që kërkojnë kohë për verifikim.

2. Administrata e KQZ-së, pas marrjes së raporteve të auditimit bën verifikimin e raportit financiar për fushatën zgjedhore duke:
  - a. krahasuar të dhënat me gjetjet dhe përfundimet në raportin e auditimit për fushatën zgjedhore, raportin përfundimtar të monitorimit, si dhe çdo informacion tjetër të marrë gjatë hetimit administrativ si rezultat i ankesave, kërkesave apo denoncimeve lidhur me shkeljet e mundshme të Kodit Zgjedhor;
  - b. kontrolluar procedurën e dokumentimit të dhurimeve nëse dhuruesi ka nënshkruar deklaratën për dhurimet sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi në shtojcën nr. 5, respektimin e kufirit të lejuar të shumës së dhurimit, si dhe nëse shuma e dhurimit të fondeve jopublike mbi kufirin e përcaktuar është transferuar në llogaritë e posaçme të hapura për këtë qëllim;
  - c. verifikuar nëse fondet e përfituara dhe shpenzimet e kryera nga kandidati i partisë politike për fushatën zgjedhore janë deklaruar në raportin e dorëzuar nga partia politike;
  - ç. rillogaritur totalin e shpenzimeve të deklaruara gjatë fushatës zgjedhore dhe duke e krahasuar atë me kufirin e lejuar për financim të subjekteve të percaktuara në nenin 1, gërma “a” të këtij vendimi.
3. Nëse nga krahasimi ndërmjet raportit financiar të subjekteve të parashikuara në nenin 1 shkronja “a” të këtij vendimi me raportin përkatës të auditimit për fushatën zgjedhore, rezulton se ka mospërputhshmëri, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve autorizon me shkrim kryerjen e verifikimeve të thelluara. Për qëllime të verifikimit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve urdhëron një riauditim nëpërmjet një audituesi të ri nga lista e ekspertëve kontabël të licencuar. Audituesi i ri, për përgatitjen e raportit ka të drejtë të:
  - a. intervistojë persona dhe subjekte të ndryshme;
  - b. marrë informacion nga autoritetet përgjegjëse për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
  - c. këqyrë dokumente që lidhen me këto verifikime të thelluara pranë zyrave përkatëse të subjekteve të percaktuara në nenin 1, gërma “a” të këtij vendimi;
  - ç. marrë çdo lloj informacioni apo të dhënë tjetër nga institucionet shtetërore, bankat apo persona të tretë.
4. Audituesi i ri harton një raport përfundimtar dhe e dorëzon në KQZ brenda afatit të përcaktuar në kontratë.
5. Pas përfundimit të procesit të riauditimit, administrata e KQZ-së i paraqet Komisionerit një relacion përfundimtar ku parashtron gjetjet nga verifikimi dhe kontrolli, si dhe rekomandimet për masa të mëtejshme. Komisioneri, brenda 48 orësh nga marrja e relacionit, miraton me shkrim gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura ose në rast se nuk bie dakord me to bën refuzimin përkatës me shkrim, duke arsyetuar refuzimin për të dhënë miratimin.

## **Neni 7**

### **Financieri**

1. Subjektet e percaktuara në shkronjën “a” të nenit 1, të këtij vendimi, pavarësisht llojit të zgjedhjeve në të cilat garojnë, duhet të caktojnë një financier. Secili prej tyre nuk mund të caktojë më shumë se një financier në të njëjtën kohë.

2. Financieri nuk duhet të jetë kandidat për t'u zgjedhur.
3. Subjektet e percaktuara në shkronjën "a" të nenit 1 ndërpresin marrëdhëniet me financierin dhe emërojnë një financier të ri në rastet kur financieri:
  - a. bëhet i paaftë për arsye shëndetësore për të kryer detyrat e tij, vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor;
  - b. dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
  - c. ka papajtueshmëri me ushtrimin e detyrës së financierit sipas pikës 2 të këtij neni;
  - ç. është në kushtet e konfliktit të interesave në raport me KQZ;
  - d. jep dorëheqjen;
  - dh. vdes.
4. Në rastin kur financieri jep dorëheqjen, ai duhet të njoftojë me shkrim subjektin që e ka caktuar dhe KQZ-në. Financieri ndërpret funksionin e tij dhe me procesverbal organizon transferimin e informacionit dhe dokumentacionit financiar të subjekteve të percaktuara në nenin 1, gërma "a" të këtij vendimi të financierit të emëruar. Subjekti i percaktuar në nenin 1, gërma "a" të këtij vendimi njofton me shkrim KQZ për emërimin e financierit të ri, jo më vonë se 3 (tre ditë) nga data e emërimit.
5. Financieri i subjekteve të percaktuara në nenin 1, gërma "a" të këtij vendimi mban përgjegjësi ligjore për veprimtarinë që kryen në menaxhimin e financave ose për mosrepektim të legjislacionit në fuqi.

## **Neni 8**

### **Përgjegjësitë e financierit**

*(Ndryshuar pika 7 dhe shtojca nr. 6, e pikës 8, me vendimin nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator)*

Financieri i subjekteve të percaktuara në shkronjën "a" të nenit 1, të këtij vendimi ka këto përgjegjësi:

1. administron veprimtarinë financiare të fushatës zgjedhore të subjekteve të percaktuara në shkronjën "a" të nenit 1, të këtij vendimi dhe veprimtarinë financiare vjetore të partisë politike,
2. regjistron të gjitha transaksionet financiare, si dhe gjurmon çdo shpenzim dhe/ose kontribut në natyrë.
3. ndjek hapjen dhe deklarimin e llogarisë bankare, në momentin e regjistrimit si subjekt zgjedhor dhe siguron që dhurimi i fondeve jopublike me vlerë më të madhe se 50 mijë lekë të bëhet vetëm në llogari të posaçme të hapura në banka nga subjektet e percaktuara në nenin 1, gërma "a" të këtij vendimi;
4. administron të gjithë aktivitetin financiar për fushatën zgjedhore të kandidatëve të partisë politike të vënë në dispozicion nga këta të fundit;
5. mbledh dhe siguron arkivimin/ruajtjen e duhur të të gjithë informacionit dhe dokumenteve mbështetëse në lidhje me financimin e fushatës zgjedhore nga subjektet e percaktuara në nenin 1, gërma "a" të këtij vendimi, përfshirë faturat, mandat pagesat, deklaratat bankare, informacionin që mbështet vlerësimin e dhurimeve në natyrë dhe deklaratat e dhuruesve;
6. kontrollon të gjitha burimet e të ardhurave, duke u siguruar se:

- a. origjina e të ardhurave, atyre monetare dhe në natyrë, është nga dhurues të ligjshëm dhe të lejur nga ligji;
  - b. vlerësimi i dhurimeve në natyrë është kryer si duhet;
  - c. nuk janë tejkaluar kufijtë në dhurime;
7. kontrollon të gjitha shpenzimet e bëra nga një subjekt zgjedhor pa përfshirë kandidatët e tij, për fushatën zgjedhore, duke vlerësuar mostejkalimin e kufirit të shpenzimeve i cili nuk duhet të jetë më shumë se 5 herë më i madh se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore;
  8. mban dhe ruan në arkiv për një periudhë prej 7 vjetësh dokumentacionin e plotë dhe të hollësishëm të statusit financiar të partisë politike dhe të degëve të saj, sipas nenit 92/3, pika 3 të Kodit Zgjedhor. Formati i regjistrit të dhurimeve të përfituara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore do të mbahet sipas Shtojcës nr. 6 që i bashkëlidhet këtij vendimi;
  9. dorëzon raportin financiar për fushatën zgjedhore duke u kujdesur që të jetë i saktë, i plotë dhe i depozituar në kohë në KQZ;
  10. jep ose siguron që t'i kthehet përgjigje në mënyrë të plotë dhe në kohë çdo kërkesë për informacion të paraqitura nga audituesi apo KQZ-ja.

## Neni 9

### **Përgjegjësitë e kandidatëve në lista shumemërorë dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit**

*(Ndryshuar pika 2 dhe shtuar pika 2/1, me vendimin nr. 12, datë 27.2.2025, të Komisionit Rregullator)*

1. Kandidatët e listave shumemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit kanë detyrimin të mbajnë kontakte të shpeshta me financierin dhe të ndjekin udhëzimet e dhëna prej tij për dokumentimin e fondeve dhe të shpenzimeve që kryejnë gjatë fushatës zgjedhore.
2. Kandidati i listës shumemërore ka detyrimin të dorëzojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e zgjedhjeve, raportin financiar të fushatës të financieri i partisë politike/financieri i partisë udhëheqëse të koalicionit.
- 2/1. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit dokumenton dhe regjistron vlerat e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e dhuruesit, huadhënësit ose kredidhënësit, sipas shtojcës nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Financieri përgjigjet për dokumentacionin e dorëzuar nga kandidatët e listave shumemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, me përjashtim të rastit kur nga hetimi administrativ vërtetohet se nuk ka pasur mundësi ose, me gjithë përpjekjet e bëra, nuk ka arritur të parandalojë ose korrigjojë shkeljen e kryer nga kandidati. Në këtë rast përgjegjësia për shkeljen i ngarkohen kandidatit të listës shumemërore/kandidatit të propozuar nga zgjedhësit.
4. Shuma e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit, huadhënësit ose kredidhënësit regjistrohen në modelet e deklarimeve që i bashkëlidhen këtij vendimi.
5. Kandidatët e listave shumemërore dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, nëse nuk kanë hapur llogarinë e posaçme në momentin e regjistrimit atëherë, nga momenti i hapjes së llogarisë së posaçme për pranimin e dhurimeve, por jo më vonë se 10 ditë nga data e zgjedhjeve, duhet ta deklarojnë atë menjëherë në KQZ.

## **Neni 10**

### **Sanksionet**

Mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar, asgjësimi i dokumenteve, vonesat ose sjellja e papërshtatshme në procesin e verifikimit të kryer nga KQZ-ja raportohet në prokurori si veprë penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe ndëshkohen administrativisht prej saj në përputhje me nenin 173 të Kodit Zgjedhor.

## **Neni 11**

### **Shfuqizim**

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, dispozitat e vendimit nr. 152, datë 11.04.2019, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore”, që parashikojnë raportet e auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara për fushatën zgjedhore si dhe raportet e monitorimit të fushatës zgjedhore, shfuqizohen.

## **Neni 12**

### **Hyrja në fuqi**

1. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

<b>Ilirjana</b>	<b>NANO -</b>	<b>Kryetare</b>
<b>Arens</b>	<b>ÇELA -</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Dritan</b>	<b>ÇAKA -</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Helga</b>	<b>VUKAJ -</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Muharrem</b>	<b>ÇAKAJ -</b>	<b>Anëtar</b>